

VENDIM
Nr. 170, datë 8.4.1997

PËR QENDRËN KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË

Në mbështetje të ligjit nr.8096, datë 21.3.1996 “Për kinematografinë” dhe me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Gruas, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendra Kombëtare Kinematografike, e krijuar sipas ligjit nr.8096, datë 21.3.1996 “Për kinematografinë”, do të jetë institucion buxhetor me klasifikim më vete në strukturën buxhetore si grup, titull, kapitull.

2. Numri i punonjësve të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë të jetë 10 veta.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 “Për pagat e punonjësve në institucionet buxhetore”, bëhen këto ndryshime:

- Në lidhjen nr.I “Pagat mujore të titullarëve të organeve të larta shtetërore, institucioneve të tjera qendrore dhe personave të një rangu me ta”, në pikën 8 dhe në lidhjen nr.II-5 “Pagat mujore dhe renditja e detyrave sipas klasave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”, në pikën 3 shtohet emërtimi “Kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”.

- Në lidhjen nr.I “Pagat mujore të titullarëve të organeve të larta shtetërore, institucioneve të tjera qendrore dhe personave të një rangu me ta”, në pikën 11 dhe në lidhjen nr.II-5 “Pagat mujore dhe renditja e detyrave sipas klasave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”, në pikën 6 shtohet emërtimi “Drejtor ekzekutiv”.

- Shtohet lidhja II-15 “Pagat mujore dhe renditja e detyrave sipas klasave për punonjësit e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë” sipas tabelës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

4. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave të përballohen nga buxheti i miratuar për sektorin e kinematografisë për vitin 1997.

5. Statuti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë të paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

LIDHJA II-15

PAGAT MUJORE DHE RENDITJA E DETYRAVE SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË

Nr.	Emërtimi	Paga ose klasa	Shtesa për funksion (grupi)
1.	Kryetar	37 000	
2.	Drejtor ekzekutiv	28 800	
3.	Shef sektori	IX	5
4.	Specialist i parë	VIII	
5.	Specialist i dytë	VII	
6.	Llogaritar i parë	V	
7.	Shofer	IV	

Shënim. Nëse del e nevojshme të ketë emërtesa të tjera, të përdoret lidhja III-5/37 “Renditja e detyrave sipas klasave për profesione të njëjta në të gjithë sektorët” dhe pagat të caktohen sipas lidhjes II/M.